



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

| | | | |
|---|------------|-------------------------------------|-----------|
| Pranuar / Dostizuar Prilaps / Pristalo Received / Delivered | 15.06.2022 | viti god year | 2 |
| Organ / Rjeshta Organ / Jedinstvo Organi / Rješenje | SKPM/HCK | Id. Prof. Id. Prof. Prof. No. | 3515/2022 |
| | | Shtet / Protog. Appendix | |
| | | Sasia Kolicina Quantity | 1/3 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.425/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën A.nr.425/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga kundër Vendimit me Nr. 13-112/12-0024767/22 të datës 04.04.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 15.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.425/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, më datë 27.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2436/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 13-112/12-0024767/22 të datës 04.04.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.05.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli, më



datë 09.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në kërkesën e Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 08.06.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.50/2022, për shtyrje të aftit për vendosje të ankesës së ankuesit për 10 ditë pune për arsye që organi i punësimit nuk ka pranuar kërkesën për përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2436/2022 të datës 27.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 13-112/12-0024767/22 të datës 04.04.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës Ankesë për Komisionin e Pranimit komuna e Podujevës i datës 29.03.2022; Kërkesë për qasje në dokumente publike i datës 01.04.2022; E-mail nga S.N. për F.B. i datës 01.04.2022; E-mail nga B.R. për S.N. i datës 01.04.2022; E-mail nga A.A. për F.B. i datës 06.01.2022; E-mail nga F.B. për A.A. i datës 05.01.2022; Përvoja e punës e B.R. nga SIMBNJ; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë e datës 09.06.2022; Konkursin e datës 01.11.2021 për GRUP Specialist i Shkencave Shoqërore; Vendimin me Nr.02-020/04-0010228/22 i datës 11.02.2022 për themelim të komisionit për vlerësimin për pranim dhe zhvillim të procedurës rekrutuese; Lista e APLIKANTËVE; Lista e kandidatëve të refuzuar dhe aprovuar; Njoftimin me Nr. 290/2021 i datës 24.12.2021 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin me Nr. 13-56/2022 i datës 07.03.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin me Nr. 13-66/2022 i datës 23.03.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Njoftimin për rezultatet e vlerësimi i datës 28.03.2022; Rezultatet pas afatit të ankesave i datës 04.04.2022; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Aplikacionin e ankuesit me dokumentet përcjellëse; Aplikacionin e kandidates me dokumentet përcjellëse; Aplikacionin e kandidates me dokumentet përcjellëse; Vendimin VK.nr.50/2022 të datës 08.08.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 15.06.2022 me numër protokollit 3488/2022 të ankuesit për tërheqje të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankueses, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës, Komuna e Podujevës ka shpallur konkursin me numër reference RN0007794 për grup Specialist i Shkencave Shoqërore respektivisht Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, në të cilin ka aplikuar dhe ankuesi, i cili i'u është nënshtruar të gjitha fazave të procedurës.

Pas përfundimit të procedurës Komuna e Podujevës, më datë 28.03.2022 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm, ku rezulton që ankuesi ka marr gjithsejtë 73.5 pikë i renditur si i dyti. Kundër këtij njoftimi ankuesi më datë 29.03.2022 ka parashtruar ankesë në



Komisionin e Pranimit. Komisioni i Pranimit i Komunës së Podujevës, më datë 04.04.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 13-112/12-0024767/22 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi më datë 27.04.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë kundër Vendimit me Nr. 13-112/12-0024767/22 të datës 04.04.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës. Ndërsa me datë 15.06.2022 ankuesi ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 3488/2022, për tërheqjen e ankesës të datës 27.04.2022, andaj, bazuar në këtë veprim të ankuesit, e në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar me ankesën A.nr.425/2022 të datës 27.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.425/2022

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

-
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

